

ARTUR LAMA

**RRETH DISA FIGURAVE GJUHËSORE LETRARE NË PROZËN
E FATOS KONGOLIT (KRAHASIMI)**

Fatos Kongoli është një nga prozatorët tanë që shfrytëzon kujdesshëm sistemin e gjuhës shqipe. Mëtimet e tij ideo-artistike sendërtohen përmes imazheve të gjetura poetike, stilistike dhe intelektuale. Arkitektura e episodeve artistike dhe e gjithë prozës së tij shpërfaqet si një album interesant. Në hapësirat e saj ndeshim rrëfime, karakterizime e përshkrime të qëlluara që vijnë tek lexuesi me anë të lojës së zërave dhe të pikëvështimeve, por edhe falë krijimit të lidhjeve të reja të fjalëve, të farkimeve të tyre të papritura, falë zbulimit të aspekteve të reja gjuhësore.¹

Në korpusin letrar të këtij prozatori që gëzon vlerësimet e lexuesit shqiptar dhe atij evropian, *ndeshim* identitete fizike e psikologjike që mbartin një mori fijesh në “kaosin e kujtesës”, *njohim* personazhe me dëshira dhe vese që i mbajnë fshehur nën vete; *zbulojmë* hartën shpirtërore, sociale të individit të një kohe ku ndodh trafikimi i identiteteve e tragjizohen fatet e jetëve të vjedhura; *zbulojmë* struktura e tekste që mbartin kuptime të figurshme të përfutuara me anë të mjeteve të shenjara stilistikisht.

Është e rëndësishme të pohojmë se në laboratorin artistik të prozatorit Fatos Kongoli gjëllin figura e kuptime që luajnë rol si në aspektin kumtues, logjik dhe në atë të ngjyritimit emocionues². Ato vijnë nga gjuha e popullit, perceptohen, strukturohen e lëmohen sipas parimeve të semantikës dhe të stilistikës moderne. Pena dhe mendja e shkrimtarit *ndalen* në realitetin e sotëm shqiptar, “*bluajnë*” morinë e madhe e të larmishme të dukurive e objekteve³, ofrojnë një begati të madhe leksikore, nxitin lexuesin të qartësojë shprehësinë dhe domethënien e figurave, por i hapin udhë studiuesit për vështirime aspektesh të ndryshme⁴.

¹ R. Qosja, “Përgjegjësia gjuhësore e shkrimtarit”, *Kontinuitete*, Prishtinë, 1972, f. 191.

² R. Berisha, “Metafora në poezinë popullore”, *Drita*, 5 qershor 1988.

³ F. Arapi, “Figura poetike në poezinë popullore (krahasimi)”, *Çështje të folklorit shqiptar*, 1982, 1, f. 330.

⁴ Sh. Islamaj, *Gjuha e Jakov Xoxës*, Prishtinë, 200, f. 9.

Pasuria gjuhësore dhe letrare, e vëllimshme, e fituar duar-duar gjatë shkrimtarisë së tij dhe e ushqyer pandërprerë nga rrjedhat e pastra ligjërimore, na jep dorë të vështrojmë disa mjete tipësore⁵ që mundësojnë një larushi sintagmash e shprehjesh të figurshme. Në këtë hulli, mund të veçojmë *krahasimin* që në shumicën e rasteve perceptohet sipas vendosjes së analogjive me emra konkretë, por edhe si mjet i parapëlqyer në prozën e F. Kongolit, *epitetin* që zë një vend të rëndësishëm në sistemin e figuracionit të tij, si dhe metaforën që thellon mendimet rreth kuptimeve të reja.⁶

Krahasimet kanë një denduri të madhe përdorimi në prozën e F. Kongolit dhe karakterizohen me ngjyrimë emocionuese, shprehësi të lartë dhe forcë individualizuese e cilësuese.⁷ Në repertorin e rrëfimeve të personazheve, të cilat në kohë të ndryshme gërshetojnë dramën e aksionit me dramën e pjekurisë, apo ndërthurin dramën e veprimit me dramën e provës⁸, ndeshim krahasime të thjeshta të shprehura me fjalë: rrëshqita rrëzë mureve *si hije*, e përpiktë *si kronometër*, rrinin *si të ngrirë*, meriton të ngordhësh *si qene* etj. por edhe krahasimet e zgjatura, të cilat strukturohen falë një larushie sintagmash: fliste me një zë të ngjirur ... *si një plak shekullor*, hapësira e ashensorit *si një pus i zi*, truri im qe bosh *si një sferë e zbrazur* dhe shprehjesh: *si ata gjahtarët e thesareve të varrosur në fundin e deteve*, *siç mbetet një mizë në fijet e merimangës*, *si skllëvër që përcillnin të tmerruar padronin* etj.

Krahasimet, si mjete tipësore, sjellin në mënyrë të natyrshme dhe autentike peizazhin e gjerë, përvojën njerëzore të konkretizuar⁹, përqasin realitetin e përfytyruar me objektet dhe fenomenet e natyrës më të afërt, më të njohur¹⁰. Në shumicën e rasteve ato karakterizohen nga vendosja e analogjive midis dy emrave konkretë, midis dy emrave abstraktë, si edhe midis emrave konkretë dhe emrave abstraktë ose anasjelltas. Duke u mbështetur në vlerën kuptimore dhe gramatikore të objektit të krahasimit dhe të krahasuarit, kur ata përdoren si emra që tregojnë sende të

⁵ J. Thomai, "Kultura gjuhësore e shkrimtarit dhe teksti", *Teksti dhe gjuha*, Tiranë, 1992, f. 97.

⁶ R. Berisha, "Metafora në poezinë popullore", *Drita*, 5 qershor 1988.

⁷ Sh. Islamaj, *Gjuha e Jakov Xoxës*, Prishtinë, 2000, f. 328.

⁸ M. Shella, *Strukturat ligjërimore në prozën bashkëkohore* (Ismail Kadare dhe Fatos Kongoli), Tiranë, 2001.

⁹ F. Arapi, "Figura poetike në poezinë popullore(krahasimi)", *Çështje të folklorit shqiptar*, 1982,1, 324.

¹⁰ R. Qosja, *Historia e letërsisë shqipe, Romantizmi*, I, Tiranë, 2000, f. 138.

numërueshme, cilësi të abstraktuara a nocione abstrakte¹¹, mund të bëjmë grupimet e mëposhtme:

a- **emër konkret + si + emër konkret:** *fashat* ma shtrëngonin kokën *si pranga*; armët i përgjigjeshin njëra- tjetrës *si qentë nëpër natë*, *njollat e gjakut si gjurmët* të një krimi, iu ktheva tryezës sime të punës *si një mikeshë e vjetër* etj.

b- **emër konkret + si + emër abstrakt:** *buburecat* dilnin nga rrëzat *si një kalorësi e zezë*, gjendej vetëm vazoja prej porcelani *si dëshmi* e një mëkati etj.

c- **emër abstrakt + si + emër konkret:** pashë inxhinierin me seriozitetin e zakonshëm, *si një maskë* të cilën nuk ia duroja, *anonimët* ishin ca maska të ngrira si mumje sarkofagësh, shfaqja halucinante *si një sekuencë filmike* etj.

d- **emër abstrakt + si + emër abstrakt:** *një ankth* nën diellin djegës të korrikut *si një arrati* në shkretëtirë drejt një të panjohure; ajo prishje absurde më rrinte në kokë *si engimë, rënkime* që u mbyllën me *një klithmë si një vuajtje e thellë* etj.

Duke u mbështetur në vlerën leksiko-gramatikore të elementeve gjuhësore kryesore të realiteteve që krahasohen për qëllime stilistike, d.m.th. të «theme-s» e «phore-s», sipas disa gjuhëtarëve evropianë apo të krahasuesit dhe të krahasuarit, objektit të krahasimit dhe parafytyrimit sipas perceptimeve të poetikës dhe stilistikës shqipe, dallojmë:

– *krahasime emërore:* zëri i tij buçiti në veshët e mi *si bori*, i kënaqej gotës së kristaltë, që e mbante dhe e rrotullonte nëpër duar *si një relike* etj.

– *krahasime mbiemërore:* Si u kthyem në dhomë ajo m'u duk *e pambrojtur* si një gazelë që shkon me këmbët e veta në gojën e tigrit (rrëfimtari e ka fjalën për Lorin, Bolero..., 131); si një skllave e magjepsur, e sunduar nga pamja e vjehrrës autoritare, infermierja (Bolero..., 39) etj.

– *krahasime foljore:* ia shpjegova edhe një herë, *siç mund t'i shpjegohet* një nëpunësi zyre, flet me zë të ulët *si të ketë frikë mos bezdisë njeri*; ai u tërhoq prapa *si një njeri* që e kanë zënë befasisht prej fyti etj.

Nga një lexim i vëmendshëm i prozës së këtij shkrimtari, vëren se krahasimet zënë hapësirë më të madhe në rrëfimet e personazheve të romanit “Ëndrra e Damokleut”, por ato nuk mungojnë edhe në romanet e tjera dhe kanë sjellë për lexuesit imazhe poetike, intelektuale, pamje e portrete interesante. Pasurimi i përshtypjeve prej ligjërimit urban i kanë

¹¹ *Gramatika e gjuhës shqipe*, I, Tiranë, 1995, f. 84.

dhënë dorë këtij prozatori të strukturojë mesazhe dhe mendime ku krahasimet mbartin role e funksione të rëndësishme njohëse, figurative, apo kur ato përdoren si mjete shprehëse e me mbartje të fuqishme emocionuese. Për nga natyra e krijimit dhe funksioni i tyre ideoartistik, mund të sjellim tipologjinë e mëposhtme:

a- *krahasime popullore*, të cilat i ndeshim në ligjërim bisedor apo në ligjërimin e thjeshtë: *si kungull*, *si qene*, *si një brumbull* i hutuar, *si një copë leckë*, *si hu gardhi*, *si i çmendur* etj.;

b- *krahasime intelektuale*. Për strukturimin e kësaj figure me domethënie të përfytyruar, autori përqas mendime e nocione abstrakte që zënë fill sipas përshtypjeve dhe logjikës vetjake. Edhe pse në këto raste krahasimi është figurë e kërkuar, ai kryen funksione racionale, sidomos kur personazhet kalojnë provën e pjekurisë dhe përqasjet e ndjenjave dhe mendimeve realizohen përmes një trajektore logjike, si: E ndiej vështrimin e tij, *si një qortim* nga një botë e vdekur; kam mbetur brenda ngjarjeve të së shkuarës, *siç mbetet një mizë në fijet e merimangës*; u ndërpre në trajektoret tona *si dy lakore të universit* etj.

Krahasimet e këtij lloji orientojnë gjykimin e folësit, të rrëfimitarit (la comparaison oriente le jugement du lecteur)¹². Ato luajnë rol të rëndësishëm në pikënisjen e një arsytimi, bëhen mbështetje e mendimit të shprehur më parë,¹³ ose e interpretimit të ambiguiteteve, në disa raste përdoren në shembullin e ilustrimit¹⁴. P.sh.: Pa Margën dhe me këto përpëlitse të shpirtit. Në këtë pikë filli i arsytimit m'u ngatërrua: në kokë më mbeti fjala shpirt *si një kokrrizë rëre që më gërricte cipën e trurit*. Dhe më futi në një hulli tjetër *si një tren i zhvendosur nga shinat*. ("Lëkura e qenit"); kësaj i thonë të *sillesh si struci*, të futësh kokën në rërë e të kujtosh se të tjerët nuk të shohin, kur të tjerët të shohin, sidomos ata dëshmitarët e përjetshëm të dobësisë tënde ("Lëkura e qenit, 279.") etj.

c-*krahasime poetike*, të cilat janë pjesë e çmuar e gjuhës së personazheve që meditojnë për veten e tyre apo ndiejnë evolucionin e trajektores shpirtërore të të tjerëve: Vera vraponte ... e mbështjellë nga stërkalat e uji *si një qenie kristalore* që del befasisht nga valët ("Ne të tre", 49); vrapoja *si mbi krahët e një ëndrre* (Ëndrra e Damokleut", 16), e

¹² M. Bonhomme, «De l'argumentativité des figures de rhétorique», *Argumentation et Analyse du Discours*, nr. 2, 2009, f. 28.

¹³ F. Arapi, "Figura poetike në poezinë popullore(krahasimi)", *Çështje të folklorit shqiptar*", 1982, 1, 339.

¹⁴ J. Cohen, « La comparaison poétique: Essai de systématique », *Langages*", 12, 1968, f. 45.

gjetëm atje ku kishim lënë, ulur në kolltuk, *si një statujë e ngrirë*, Firdus (“Bolero në vilën e pleqve”, 38), qëndroi në këmbë nën dritën e hënës *si një shtatore e bardhë*, u shfaq *si një shtatore bronzi* (“Ëndrra e Damokleut”, 264); babai u përshëndet me gruan që rrinte aty pranë *si një statujë e lashtë* (“Ne të tre”, 27) *si një sfinks i heshtur* rrëzë kodrës korpusi i bardhë i Fakultetit Ekonomik etj.

Bukuria dhe pamja estetike e sytheve dhe e pjesëve narrative që përmbajnë mjete të tilla stilistike, tregojnë se sa shumë shkon vlerësimi për këtë prozator modern “se është e vështirë të bëhesh një prozator i mirë, pa qenë më parë poet.”¹⁵

d- krahasime animizuese. Përvoja e pasur artistike e ka ndihmuar shkrimtarin e madh që, për krijimin e sa më shumë imazheve stilistike, t’u drejtohet izotopive¹⁶ që lidhen me natyrën dhe me botën e kafshëve. Kështu, po të kundrojmë me vëmendje kujtimet e personazheve kryesore për kohën e shkuar, por sidomos rrëfimet të figurshme me relief të spikatur nga konfiguracioni gjeografik dhe bota e kafshëve, vërejmë se ato sendërtohen falë *krahasimeve*: vazhdonte të binte heshturazi *shiu si një trishtim qiellor*, *si skifterë* të trembur që larguar çifti i fjalëve torturuese, *si një kafshim i viteve* ajo plagë e vjetër, një bisedë e tillë nuk ishte hapur midis nesh, *si një plagë* që ka zënë kore, bredhat e lulishtes *si roja të vetmuara* etj.

e- *krahasimet që përdoren për individualizimin ligjërimor të personazheve*. Nga parapëlqimet e tij stilistike, krahas leksikut, sintaksës së fjalive, klisheve ligjërimore, shprehjeve frazeologjike, dendurisë së epiteteve dhe metaforave¹⁷, mund të veçohet prirja për t’u drejtuar krahasimeve të gatshme *nga një ligjërim i caktuar*¹⁸ ose *imtësive lëndore e psikologjike* që fshihen prapa përqasjes së dy objekteve të krahasuara. Kështu, në dhjetëra episodeve narrative, qëndrimi ideo-emocionor i tij sendërohet falë paraqitjes së ngjashmërive të termave të krahasimit nga jeta e përditshme, falë përqasjes midis njeriut dhe botës së kafshëve jo në

¹⁵ “Musique”, cité par Albert Béguin, in Gérard de Nerval, *Poésies*, Mermod, Lausanne, 1944, p. 182

¹⁶ La Figure de la comparaison dans les œuvres de Gustave Flaubert et de Robert Musil, ou le paradigme ironico-poétique.

¹⁷ Fatos Beja, « Karakterizimi dhe individualizmi ligjërimor i personazheve në prozën tonë të sotme », *Studime filologjike*, 1989, 4, f. 103.

¹⁸ Fatos Beja, “Rreth figuracionit në prozën e sotme shqiptare”, *Studime filologjike*, 1982, 1, f. 52.

një gjendje statike, por në mënyrë dinamike¹⁹. Krahasimet u mundësojnë fjalëve dhe sintagmave që përdoren për karakterizim përbërës semantikë a kuptime shtesë me ngjyime emocionale të fuqishme²⁰. Sipas këtij vështrimi dallojmë:

1- krahasimet që mbartin ngjyime emocionuese për karakterizimin moral të personazheve: *si një kafshë e lodhur* Hipopotami; *si një qene rrugësh e shporrur*, *si të isha sendi i dekorit*, *si një qese plastmasi* më flaku në trotuar; mbeti në karrige e trembur *si një fëmijë* që i kanë dhënë një dackë të pamerituar, dukej *si një këngëtar lirik* për shkak të zërit të hollë; mami më dukej *si një gjeneral i shkathët* që i ka të qarta të gjitha episodet e jetës etj.;

2- krahasimet që mbartin një larushi emocionale për karakterizimin fizik të personazheve: po kapërcente pragun duke u tundur *si patë*, i thinjur *si dele* ishte Xha Brahoja, Didia ishte e rritur aq sa dukej si grua e madhe, me prapanicat sa një baule, Afërdita gjyqtare, një djalë i ri, *i gjatë e i hollë si pincë* etj.

Nga sa përmendëm më sipër, mund të përfundojmë se në prozën e F. Kongolit gjëllin figura e kuptime që luajnë rol si në aspektin kumtues, logjik dhe atë të ngjyritimit emocional. Midis figurave me denduri të madhe përdorimi, është edhe figura e krahasimit. Në laboratorin artistik të këtij prozatori me vizione bashkëkohore sendërtohen imazhe të gjetura stilistike dhe intelektuale, mundësohen karakterizime e përshkrime të qëlluara që vijnë tek lexuesi me anë të lojës së zërave dhe të pikëvështrimeve që kanë si çelës stilistik krahasimin.

BIBLIOGRAFI

- Arapi, F., “Figura poetike në poezinë popullore”, *ÇFSH*, 1982, 1.
 Bacry, P., *Les Figures de style et autres procédés stylistiques*, Paris, Armand Colin, coll. «Collection Sujets», 1992.
 Berisha, R., “Metafora në poezinë popullore”, *Drita*, 5.6.1988.
 Beja, F., “Rreth figuracionit në prozën e sotme shqiptare”, *Studime filologjike*, 1988, 2, f. 41-58.
 Beja, F., “Karakterizimi dhe individualizmi ligjërimor i personazheve në prozën tonë të sotme”, *Studime filologjike*, 1989, 4, f. 101-107.

¹⁹ Q. Haxhihasani, “Disa të dhëna rreth figuracionit të lirikës popullore shqiptare”, *Studime filologjike*, 1972, 2, f. 22.

²⁰ F. Beja, “Shprehësia konotative e fjalëve në prozën tonë të sotme artistike”, *Studime filologjike*, 1991, 1, f. 147.

- Beja, F., "Shprehësia konotative e fjalëve në prozën tonë të sotme artistike", *Studime filologjike*, 1991,1, f. 141-149.
- Berati, L., "Tipare të formës artistike në romanet e Jakov Xoxës", *Studime filologjike*, 1989/3, f. 39-49.
- Bonhomme, M., «De l'argumentativité des figures de rhétorique», *Argumentation et Analyse du Discours*, n° 2, 2009.
- Goga, A., "Vështrim mbi disa sintagma të figurshme në letërsinë artistike", *Studime filologjike*, 2004, 3-4, f. 59-82.
- Harka S., "Epiteti në këngët e Luftës Nacionalçlirimtare", *Studime filologjike*, 4, 1979.
- Haxhihasani, Q., "Disa të dhëna rreth figuracionit të lirikës popullore shqiptare", *Studime filologjike*, 1972, 2, f. 15-22.
- Islamaj, Sh., "Fjalëformimi dhe shprehësia stilistike në gjuhën e Fishtës", *Gjuha shqipe*, Prishtinë, 2009, 3.
- Jaço, L., Disa dukuri të krahasimit të qëndrueshëm në ligjërimin popullor, "Gjuha jonë", 1985, 3, 20-25.
- Jakova, S., "Parime të ndërtimit të figurave artistike në tregimin tonë", *Studime filologjike*, 1976, 4, f. 9-29.
- Jakupi, M., "Metafora absolute si tregues i modernizmit në poezinë e Ismail Kadaresë", SF, 2009,1-2, f. 157-188.
- Klosi, A., "Një vështrim mbi gjuhën e prozatorit tonë të shquar Jakov Xoxa", *Gjuha jonë*, 1983, 2, 61-66.
- Podgorica, F., "Natyra dhe funksioni i figurave klasike në epikën heroike shqiptare", *ÇFSH*, 2, 1987.
- Pogaçi, K., "Lëvizja dhe figuracioni në poezinë popullore", *Drita*, 14.09.1980.
- Robrieux, J.-J., *Les Figures de style et de rhétorique*, Paris, Dunod, coll. «Les topos», 2004.
- Robrieux, J.-J., *Éléments de rhétorique et d'argumentation*, Paris, Dunod, 1993.
- Ruci, Ll., "Mbi figuracionin e lirikës popullore", *Nëndori*, 1979, 5.
- Thomai, J. "Kultura gjuhësore e shkrimtarit dhe teksti", *Teksti dhe gjuha*, Tiranë, 1992, f. 93-99.
- Xhaferaj, N., *Vështrim i figurave stilistike në traditën shqiptare dhe në trajtimet bashkëkohore*. (disertacion).

